



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

---

Cnr.732/11

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** në përbërje nga gjyqtari Shaban Shala, me procesmbajtësen Luljeta Susuri, në çështjen juridike të paditësit KEDS Distrikti në Prizren, kundër të paditurit E.G nga Prizreni, lidhur me kompensimin e dëmit, vlera kontestit 1.494,54 € pas mbajtjes së seancës kryesore në prezencën e të autorizuarës së paditësit, e në mungesë të paditurit, me **dt.07.11.2013**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit KEDS Distrikti në Prizren, me të cilën ka kërkuar që i padituri E.G nga Prizreni, paditësit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar me kryerjen e veprës penale në shumën prej 1.494,54 €, me kamatë ligjore nga data e kryerjes së veprës penale si dhe t'ia paguaj shpenzimet procedurale të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditësit.

**A r s y e t i m**

Paditësi në këtë gjykatë ka paraqitur padinë për kompensimin e dëmit kundër të paditurit, ashtu që i padituri të obligohet t'ia paguaj shumën prej 292,95 € si pasoj e kryerjes së veprës penale, me kamatë ligjore nga data e kryerjes së veprës penale.

Në shqyrtimin kryesor të datës 11.04.2013 dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e paditësit ka mbetur në tërësi si në padi dhe kërkesëpadi duke propozuar që pas administrimit të provave të obligoj të paditurin që të kompensoj dëmin në shumën prej 292,95 € me kamatë sipas vendimit të gjykatës dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale për taksën gjyqësore në shumën prej 15 €.

Në shqyrtimin kryesor të datës 11.04.2013 dhe në fjalën përfundimtare i padituri ka deklaruar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar për shkak se gjatë kohës ku supozohet se është shkaktuar dëmi ka qenë në qëndrim në Gjermani që nga viti 1999 e deri më datën 28.04.2005 ku është kthyer vullnetarisht nga Gjermania, i cili fakt vërtetohet nga prova materiale – dokumenti i kthimit nga Gjermania me numër 105284 i datës 17.03.2005. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Gjykata në shqyrtimin kryesor më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: ka bërë shikimin aktvendimin P.nr.108/05 i datës 06.11.2009, ka bërë shikimin në faturën me numër 352/04 të datës 03.11.2004 dhe ka bërë shikimin në dokumentin e kthimit me numër 105284 të datës 17.03.2005, dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit pasi ka vërtetuar gjendjen faktike si më poshtë:

Nga aktvendimi P.nr.108/05 gjykata vërteton faktin se Procedura penale kundër këtu të paditurit pushohet për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, dhe e dëmtuara udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Nga shikimi i faturës me numër 352/04 të datës 03.11.2004 gjykata njoftohet se paditësi të paditurin e ka obliguar që të kompensoj dëmin në shumën prej 292,95 € gjoja për shkak të shpenzimit të energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar.

Nga shikimi i dokumentit të kthimit me numër 105284 të datës 17.03.2005, gjykata vërteton faktin se i padituri ka qëndruar në Gjermani prej vitit 1999 gjerë më datën 28.04.2005 i cili fakt vërtetohet nga vula hyrëse e UNMIK-ut e kësaj date.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike se në bazë të aktvendimit të Gjykatës komunale në Prizren P.nr.108/05 të datës 06.11.2009 këtu i padituri nuk është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes nga neni 252 par 1 të KPK-së i cili vendim do të obligonte gjykatën në këtë çështje kontestimore sa i përket fajësisë, duke marrë për bazë se fatura e paditësit në shumën prej 292.95 € është lëshuar me supozimin se i padituri është kryesi i veprës penale që në rastin konkret do të thotë shkaktari i dëmit e i cili fakt nuk është vërtetuar me asnjë provë dhe përfundimisht duke pasur për bazë deklaratën e të paditurit si dhe dokumentin e kthimit nr.105284 të datës 17.03.2005 gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për shkak se periudha e përfshirë me padi deri më datën 07.10.2004 (data e supozuar e kryerjes së veprës penale dhe shkaktimit të dëmit), dhe pas sajë e deri më datën 28.04.2005 i padituri ka qëndruar në Gjermani dhe nuk ka pasur kurrfarë mundësie që paditësit ti shkaktoj dëmin si në padi. Deklaratës së të paditurit dhe kësaj prove materiale-dokumentit të kthimit gjykata ia falë plotësisht besimin pasi janë logjike dhe e plotësojnë njëra-tjetrën.

Andaj gjykata në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar për shkak se nuk ekziston baza e përgjegjësisë në kuptim të nenit 154 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452 të LPK.

Nga arsyerat e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**Cnr.301/10 të dt.11.04.2013**

**Proçesmbajtësja  
Luljeta Susuri**

**Gjyqtari  
Shaban Shala**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.